

Roli i Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit

Drejtorja e Përgjithshme e Antikorrupsionit është struktura teknike, në nivel qendror, përgjegjëse për hartimin, koordinimin, zbatimin dhe monitorimin e politikave kundër korrupsionit në Shqipëri.

Drejtorja e Përgjithshme e Antikorrupsionit harton dhe ndjek kuadrin strategjik kundër korrupsionit, përgatitjen e kuadrit ligjor kundër korrupsionit, hartimin dhe zbatimin e mekanizmave të integritetit, politikave dhe aktivitetet e ndërgjegjësimit dhe të edukimit kundër korrupsionit. Është gjithashtu përgjegjëse për kryerjen e verifikimit (hetimit administrativ) të denoncimeve/ankesave për praktika abuzive, korruptive apo arbitrare për zbatimin e ligjshmërisë, si dhe identifikimin e punonjësve të institucioneve publike që kryejnë abuzime me detyrën. Drejtorja e Përgjithshme e Antikorrupsionit koordinon mekanizmin e referimit, të Koordinatorëve Antikorrupsion.

Buletini elektronik është një mjet komunikimi që synon të informojë aktivitetet kryesore, iniciativat dhe zhvillimet në fushën e luftës kundër korrupsionit, duke ofruar një përmbledhje mujore të punës së institucionit.

Aktivitetet përgjatë muajit qershor, 2026**Zhillohet në Tiranë forumi rajonal për zbatimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara Kundër Korrupsionit**

9 - 11.06.2026: Drejtori i Përgjithshëm i Antikorrupsionit, z.Skerdi Tushi, mikpritësi në Tiranë, çeljen e punimeve të Forumit Rajonal mbi zbatimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara Kundër Korrupsionit (UNCAC). Përfaqësues të institucioneve publike, punonjës të organizatave të shoqërisë civile dhe partnerë ndërkombëtarë, të 5 vendeve të rajonit të Ballkanit Perëndimor, Shqipëri, Maqedoni e Veriut, Mali i Zi, Bosnje dhe Hercegovinë dhe Serbi u mbledhën për të ndarë eksperiencat dhe sfidat për zbatimin e angazhimeve që burojnë nga Konventa e UNCAC. Drejtori i Përgjithshëm i Antikorrupsionit, z.Skerdi Tushi, promovoi rëndësinë e bashkëpunimit ndërinstitucional, transparencës dhe llogaridhënies për avancimin e reformave antikorrupsion, dhe e konsideroi forumin si një platformë të përbashkët bashkëpunimi dhe dialogu dhe ndau me pjesëmarrësit disa prej eksperiencave të kryera nga administrata shqiptare me fokus kuadrin parandalues të korrupsionit. Përgjatë tre ditëve të forumit, sesionet u ndalën në forcimin e integritetit në sektorët me risk të lartë, transparencën e veprimeve të prokurimit publik, përdorimin e teknologjisë, dhe kontrollin në financimin e partive politike. Shqipëria solli në këtë forum gjithashtu eksperiencën e saj me kryerjen e ciklit të dytë të vlerësimit të zbatimit të Konventës së UNCAC (kreu II dhe V). Forumi i dha një hapësirë të dedikuar edhe bashkëpunimit me shoqërinë civile, për një zbatim efektiv të UNCAC me ngritjen e mekanizma funksionalë institucionalë. Forumi rajonal u zhvillua në Tiranë nën koordinimin e drejtpërdrejtë të Zyrës së Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin (UNODC) dhe Agjencisë Austriake për Zhvillim.

**Konferencë mbi Direktivën e BE-së kundër korrupsionit dhe reformat në Shqipëri**

24.06.2026: Kuadri rregullator i ri i Bashkimit Evropian, direktiva mbi antikorrupsionin shërbeu si indicje për zhvillimin e konferencës me titull "Direktiva e Bashkimit Evropian mbi antikorrupsionin dhe ndikimi i saj në reformat e sundimit të ligjit në Shqipëri". Me iniciativën e grupit të ekspertëve të projektit EU4GG të Delegacionit të Bashkimit Evropian në Tiranë, dhe në bashkëpunim të ngushtë me kabinetin e Ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit, konferenca ofroi një platformë Shqipëri-BE, për të diskutuar rëndësinë e Direktivës për Antikorrupsionin dhe rëndësinë e saj për procesin e integritetit të Shqipërisë në BE. Diskutimet në konferencë u mbajtën rreth proceseve të vlerësimit dhe sistemet e menaxhimit të riskut të korrupsionit, dhe mbi forcimin e mekanizmave të sinjalizimit dhe mbrojtjes së sinjalizuesve. Përmes shkëmbimit të pikëpamjeve ndërmjet institucioneve shqiptare, ekspertëve, shoqërisë civile dhe partnerëve ndërkombëtarë u evidencua rëndësia e një qasjeje të koordinuar dhe të qëndrueshme në zbatimin e reformave antikorrupsion. Konferenca rikonfirmoi rëndësinë e forcimit të instrumenteve parandaluese dhe të zbatimit efektiv të standardeve evropiane në luftën kundër korrupsionit. Vëmendje e veçantë iu kushtua sfidave praktike të zbatimit, nevojës për kapacitete institucionale dhe përdorimit të të dhënave konkrete për të matur progresin. Drejtorja e Përgjithshme e Antikorrupsionit konfirmoi angazhimin e saj institucional për zbatimin e prioritetëve kombëtarë në kuadër të procesit të anëtarësimit në BE. Konferencës iu bashkuan ekspertë të Agjencisë Italiane Kundër Korrupsionit (ANAC), ekspertë të Iniciativës Rajonale Antikorrupsion (RAI), ekspertiza teknike hulumtuese e Transparency International si dhe zyrtarë të Komisionit Evropian.

Drejtorja e Përgjithshme e Antikorrupsionit promovon integritetin institucional përmes verifikimeve dhe hetimeve administrative

1-30.06.2026: Drejtorja e Përgjithshme e Antikorrupsionit vijoi me ndjekjen e rasteve të dyshuara të korrupsionit, me verifikime dhe hetime administrative, duke trajtuar ankesat dhe denoncimet e administruara direkt nga struktura e hetimit si edhe nga Koordinatorët Kundër Korrupsionit. Verifikimet janë fokusuar në raste që lidhen me mosrespektimin e procedurave administrative, tejkalimin ose mosushtrimin e kompetencave, mungesën e transparencës në vendimmarrje, vonesat në ofrimin e shërbimeve publike dhe problematika të tjera që cenojnë integritetin e administratës publike. Pas analizës së dokumentacionit dhe provave të administruara, si dhe vlerësimit të natyrës së shkeljeve të konstatuara, ndikimit të tyre në funksionimin e institucionit dhe përgjegjësisë individuale të punonjësve të përfshirë, është propozuar një masë disiplinore. Në funksion të rolit të saj parandalues, Drejtorja e Përgjithshme e Antikorrupsionit ka dhënë rekomandime për përmirësimin e praktikave institucionale dhe forcimin e mekanizmave të integritetit. Në raportin përfundimtar të muajit qershor, janë propozuar dy rekomandime, (1) me tematikë adresimin e problematikave të natyrës administrative dhe të lidhura me përmirësimin e procedurave konkrete të punës, dhe (2) adresimin e problematikave organizative, duke synuar forcimin e mekanizmave të menaxhimit të brendshëm dhe rritjen e efektivitetit institucional.

Raportoni raste të korrupsionit pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit në adresë: koordinatori.ak@dpak.gov.al

**Nis procesi i vlerësimit të riskut të korrupsionit në shëndetësi, arsim, tatime, dogana dhe prona**

1-30.06.2026: Sektorët e shëndetësisë, arsimit, tatime, dogana dhe prona kanë nisur vlerësimin teknik të riskut të korrupsionit. Mbështetur në urdhrat e nënshkruara nga Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin janë ngritur grupet e punës, të përbashkëta me anëtarë të Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit dhe Koordinatorët Kundër Korrupsionit, të cilët së bashku me anëtarët e grupeve pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të Ministrisë së Arsimit, të Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar, të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës po evidencojnë faktorët e riskut të korrupsionit që hasen në proceset e tyre të punës. Vlerësimi i riskut të korrupsionit pranë këtyre institucioneve dhe fushave ka atashuar gjithashtu edhe ekspertizën e BE, të cilës do të japin vlerësimin e pavarur për sektorët. Në përfundim të vlerësimit do të hartohet raporti për secilin sektor dhe së bashku me planin e veprimit, pas dakordësimit me Drejtorinë e Përgjithshme të Antikorrupsionit do të dërgohet ër miratim nga kërret e institucioneve të vlerësimit. Vlerësimi i riskut të korrupsionit do të përfundojë brenda muajit dhjetor 2026.



Vlerësimi i Riskut të Integritetit në Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore do të mbështetet në metodologji të fushës

01 & 18.06.2026: Në kuadër të forcimit të mekanizmave të parandalimit të korrupsionit në nivel vendor, Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit dhe Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore po hartojnë dokumentin “Metodologjia për Vlerësimin e Riskut të Integritetit në Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore”. Përgjatë qershor 2026, janë zhvilluar mbledhjet e grupit të përbashkët të punës së bashku me ekspertë të pavarur, të jashtëm, të lehtësuar nga Këshilli i Evropës. Dokumenti “Metodologjia për Vlerësimin e Riskut të Integritetit në Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore” do të përmbajë fushat për vlerësim, të karakterit të përgjithshëm dhe specifik të veprimtarisë së njësisë të vetëqeverisjes vendore (bashki dhe qarqe). Një adresim të dedikuar do të kenë edhe bashkit që kanë veprimtari të posaçme sipas shtrirjes gjeografike dhe veprimtarisë juridikionale që kryejnë. Metodologjia do të shërbejë si një dokument standard orientues për njësitë e vetëqeverisjes vendore (bashkie dhe qarqe) për të kryer identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e risqeve të integritetit, si dhe hartimin dhe zbatimin e Planeve të Integritetit, me synim forcimin e integritetit institucional dhe parandalimin e korrupsionit në nivel vendor.

